



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
KËSHILLI DREJTUES

V E N D I M

Nr.1, datë 15.01.2019

PËR

“SHQYRTIMIN E ANKIMIT ADMINISTRATIV TË SUBJEKTIT “UNIFI HOLDING INC, DEGA SHQIPËRI”, ME OBJEKT ANULLIMIN E VENDIMIT PËR DËNIMIN ME GJOBË ME NR. SERIE 000145, NR. 152, DATË 06.12.2018”

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), me pjesëmarrjen e:

- | | |
|-------------------------|---------|
| 1. Z. Ilir Zela | Kryetar |
| 2. Znj. Edlira Dvorani | Anëtar |
| 3. Znj. Klarina Allushi | Anëtar |

dhe sekretare Znj. Ina Nuellari, në mbledhjen e datës 15.01.2019, konform procedurës së përcaktuar në Ligjin Nr. 9918, datë 19.05.2008, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Rregulloren e Brendshme për “Funksionimin e Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare”, miratuar me Vendimin Nr.7, datë 16.02.2017 të Këshillit Drejtues dhe Ligjin Nr.8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, shqyrtoi çështjen me objekt:

- 1. Shqyrtimin e ankimit administrativ të subjektit “Unifi Holding INC, Dega Shqipëri”, me objekt anullimin e vendimit për dënimin me gjobë me nr. serie 000145, nr. 152, datë 06.12.2018.**

BAZA LIGJORE:

1. Neni 114, 115 dhe neni 132 e vijues i Ligjit Nr.9918, datë 19.5.2008, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji 9918/2008*);

2. Neni 46 i Ligjit Nr.10433, datë 16.06.2011, “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë (**ligji 10433/2011**);
3. Neni 128 e vijues i Ligjit Nr.44/2015, datë 30.04.2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” (**ligji nr. 44/2015**);
4. Ligji Nr.10 279, datë 20.5.2010, “Për kundërvajtjet administrative” (**ligji 10279/2010**)
5. Rregullore Nr.46 “Metodika e Inspektimit të Veprimtarisë së Sipërmarrësve të Rrjeteve dhe të Shërbimeve të Komunikimeve Elektronike”, miratuar me Vendim Nr.2695, datë 27.10.2016 (**Rregullore nr.46**);
6. Rregullore e Brendshme e Funkcionimit të Këshillit Drejtues të AKEP, miratuar me Vendimin Nr.7, datë 16.02.2017 të Këshillit Drejtues të AKEP;

K Ë S H I L L I D R E J T U E S :

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

1. Ankimi administrativ i paraqitur nga subjekti “UNIFI Holding Inc, Dega Shqipëri”;
2. Relacioni Shpjegues/Shoqërues i projekt vendimit të përgatitur nga DJI (**Relacioni**);
3. Projekt Vendimi i formatuar dhe arsyetuar,

si dhe duke iu referuar diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, dhe bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N :

I. VLERËSIMI PARAPRAK:

1. Pas shqyrtimit paraprak të ankimit administrativ të paraqitur me shkresën nr. 2735 Prot. datë 17.12.2018 i AKEP, nga subjekti “Unifi Holding Inc, Dega Shqipëri”, me objekt “Anullimi i Vendimit për Dënim me Gjobë Nr. Serie 000145, nr. 152, datë 6.12.2018”, Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare konstatoi se subjekti në fjalë ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë AKEP dhe plotëson kushtet e pranimit sipas nenit 132 dhe 135 të Ligjit nr.44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.

Në këto kushte AKEP, mori në shqyrtim në themel objektet e ankesës të subjektit “Unifi Holding Inc, Dega Shqipëri”.

II. RRETHANAT E ÇËSHTJES:

2. Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare ka ushtruar veprimtarinë inspektuese pranë subjektit “Unifi Holding Inc, Dega Shqipëri”, prej datës 17.09.2018 deri në datën 28.09.2018, si dhe për shkak të kompleksitetit të çështjes me Vendim për shtyerje të afatit të inspektimit prej datës 01.10.2018- 12.10.2018.
3. Në përfundim të veprimtarisë inspektuese, Grupi i Inspektimit pranë AKEP, ka kualifikuar shkeljet e konstatuara, si kundërvajtje administrative në referim të nenit 135, pika 1, germa a) të **ligjit 9918/2008**: “...kur inspektorët e AKEP-it vërtetojnë se një sipërmarrës i rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike publike ose çdo person tjetër fizik a juridik, që ushtron veprimtari në fushën e komunikimeve elektronike, ka shkelur këtë ligj dhe rregulloret e miratuara: i propozojnë Këshillit Drejtues të AKEP-it masën e gjobës sipas nenit 137 pika 1 të këtij ligji, për shkeljet e parashikuara në paragrafët I deri në IV të tij, dhe masat për ndreqjen e shkeljes së konstatuar”. Në vijim, grupi i inspektimit ka hartuar Proces-Verbalin e Inspektimit në datë 19.10.2018 duke vënë në dijeni dhe subjektin në fjalë.
4. Referuar nenit 137, pika 1, paragrafi I-rë, nën pika 19, paragrafi V, nënpika 2, si dhe paragrafi VII i **ligjit 9918/2008**, grupi i inspektimit ka propozuar penalizmin me masë administrative me gjobë sipërmarrësin “Unifi Holding INC, dega Shqipëri”, pasi nuk ka dorëzuar të dhënat dhe dokumentacionin e kërkuar nga inspektorët, konform nenit 132 pika 3 të ligjit në fjalë, si dhe nuk ka lejuar kryerjen e veprimeve të inspektimit në rastin e verifikimit të pajisjeve. Gjithashtu, propozimi i Grupit të Inspektimit mbështetet dhe nga dispozitat e Rregullores Nr. 46 “Metodika e Inspektimit të Veprimtarisë së Sipërmarrësve të Rrjeteve dhe të Shërbimeve të Komunikimeve Elektronike”, miratuar me Vendim Nr.2695, datë 27.10.2016, ku përcaktohet ndër të tjera se:

“Subjekti i përcaktuar në autorizimin e inspektimit, me marrjen e njoftimit të inspektimit, është i detyruar ligjërisht dhe merr masat e duhura për t’i mundësuar inspektorëve realizimin e inspektimit.

Përfaqësuesi i subjektit është përgjegjës për vënien në dispozicion të inspektorëve të:

- dokumentacionit dhe informacionit të kërkuar,
- ambienteve teknologjike ku janë instaluar pajisjet,
- infrastrukturës së rrjetit dhe faciliteteve shoqëruese,
si dhe për:
- bashkëpunimin dhe mos pengimin e kryerjes së veprimeve të inspektimit;
- dhënien e shpjegimeve të nevojshme.

5. Grupi i inspektimit pasi vlerësoi shkeljet e konstatuara përgjatë ushtrimit të veprimtarisë inspektuese në referim me gërmën a), pika 1, të nenit 135, të **Ligjit 9918/2008**, ka përcjellë pranë Këshillit Drejtues të AKEP (**KD-së**) kërkesën për miratimin e propozimit për penalizimin e subjektit “Unifi Holding Inc, Dega Shqipëri”, me masën administrative me gjobë në masën 50,000,000 lekë, për shkak të pengimit të grupit të inspektimit për

verifikimin e paisjeve që subjekti disponon, si dhe për shkak të mosdorëzimit të të dhënave dhe dokumentacionit të kërkuar nga inspektorët sipas afateve kohore të përcaktuara në Autorizimin e Inspektimit.

6. Këshilli Drejtues i AKEP, pasi zhvilloi seancë dëgjimore me përfaqësues të subjektit në fjalë dhe përfaqësues të grupit të inspekitimit, me Vendimin nr. 91 dt. 20.11.2018, ka miratuar propozimin e inspektorëve, për dhënien e masës administrative me gjobë, në vlerën 50.000.000 (pesëdhjetë milion) lekë, ndaj sipërmarrësit “Unifi Holding INC, dega Shqipëri”. Në Vendimin nr. 91, datë 20.11.2018, pasqyrohet në mënyrë të qartë dhe përtej çdo dyshimi, vërtetësia e shkeljes së konstatuar, e që ka të bëjë me mosdorëzimin e dokumentacionit të kërkuar nga grupi i inspektimit, lidhur me aktivitetin e subjektit të inspektuar dhe moslejimin e inspektorëve për kryerjen e inspektimit.
7. Konkretisht, në seancën e datës 20.11.2018, përfaqësuesit e subjekti “Unifi Holdings INC dega Shqipëri”, parashtruan pretendimin se subjekti nuk ka zhvilluar veprimtari për vitet 2015, 2016, dhe se nuk kishin dijeni mbi faturat e lëshuara nga “Vodafone Albania sh.a”, si dhe pretenduan se këto fatura janë lëshuar gabim në drejtim të subjektit “Unifi Holdings INC dega Shqipëri”, pasi duhet të lëshoheshin për shoqërinë mëmë. Përfaqësuesit e grupit të inspektimit sqaruan se faturat tatimore të shitjes nga Vodafone Albania sh.a janë lëshuar drejt subjektit Unifi Holding INC në numër NIPT të degës Shqipëri K92430001J si dhe në funksion të Marrëveshjes së Interkoneksionit midis Vodafone Albania dhe Unifi Holdings INC dega Shqipëri. Ky pretendim është ngritur përsëri nga subjekti edhe në ankimin administrativ.
8. Nga verifikimi teknik rezulton se e vetmja pikë interkoneksioni e deklaruar për të kryer tranzitimin e thirrjeve midis “Vodafone Albania sh.a” dhe “Unifi Holdings INC, dega Shqipëri” ndodhej në ambientet e “Vodafone Albania sh.a”. Përfaqësuesit e subjektit deklaruan se për tre vite (2014, 2015 dhe 2016) subjekti nuk ka zhvilluar aktivitete dhe kjo bazuar në pasqyrat financiare të dorëzuara në QKB nga subjekti “Unifi Holdings Inc Dega Shqipëri”, por aktivitete ka zhvilluar vetëm në vitin 2017 vërtetuar kjo me pasqyrat financiare përkatëse.
9. Në vazhdim, vlen të theksohet se subjekti ankimues nëpërmjet ankimit me objekt *“Anullimi i Vendimit për Dënim me Gjobë Nr. Serie 000145, nr. 152, datë 6.12.2018”*, ka parashtruar se:
 - *Konkluzionet e inspektorëve të AKEP të reflektuara në vendim, nuk janë të bazuara në prova por në prezumime;*
 - *Nga ana tjetër, AKEP nuk mund të akuzojë ankuesin se nuk i vënë dispozicion inspektorëve faturat në fjalë, sepse ankuesi nuk posedon asnjë prej tyre;*
 - *Inspektorët kanë patur të gjithë mundësinë ligjore për të provuar prezumimet e tyre pranë “Vodafone Albania sh.a.”, por për arsye aspak të ligjshme, duket se AKEP nuk e*

ka ndërmarrë këtë hap por ka preferuar të dënojë ankuesin me gjobë bazuar vetëm në prezumime dhe jë në prova;

- Ankuesi nuk e ka të qartë se cilat janë paisjet për të cilat ai ka penguar grupin e inspektimit që të verifikojë;

- Sipas AKEP, ankuesi ka refuzuar të vërë në dispozicion dokumentet e mëposhtme:

a). Çertifikatë e paisjeve që janë në përdorim;

b). Lista e punonjësve me sigurimeve shoqërore;

c). Kohën e fillimit të matjeve të treguesve të cilësië së shërbimit.

10. Sikurse konstatohet më lartë, ky ankimim nuk përmban asnjë element të ri apo të pashqyrtuar më parë gjatë seancës dëgjimore të zhvilluar midis Këshillit Drejtues të AKEP dhe subjektit ankimues, ndërkohë që Vendimi i Këshillit Drejtues Nr.91, datë 20.11.2018 por dhe ky Vendim i KD-së të AKEP, i nxjerrë në funksion të shqyrtimit të ankimit administrativ në fjalë sqaron në pikpamje teknike dhe ligjore të gjitha shkeljet e konstatuara e më tej të provuara nëpërmjet veprimtarisë inspektuese të strukturës përkatëse pranë AKEP.

Në përfundim, Këshilli Drejtues i AKEP gjykon se:

11. Në konkluzion, nga informacioni i depozituar nga sipërmarrësi objekt inspektimi përmes pasqyrave financiare të depozituara në organet tatimore dhe pranë grupit të inspektimit, parashtrohej moskryerja e aktivitetit në vitet 2014-2016, ndërkohë që nga informacioni i përfutur nga “Vodafone Albania” sh.a, e për më tepër dhe nga faturat tatimore të vëna në dispozicion nga vetë subjekti nëpërmjet shkresës të datës 25.10.2018, në zbatim të marrëveshjes së interkoneksionit ndërkombëtar midis dy sipërmarrësve, rezulton se “Unifi Holdings Inc, Dega në Shqipëri” ka kryer aktivitetet edhe në periudhën në fjalë.

12. Subjektit i është kërkuar në mënyrë të vazhdueshme nga grupi i inspektimit, të paraqesë dokumentacionin të plotë lidhur me veprimtarinë e tij, ndërkohë që nuk është paraqitur deklarimi i të ardhurave nga shërbimet e Komunikimeve Elektronike (tranzit thirrje hyrëse ndërkombëtare) për vitet 2015, 2016. Mosvënia në dispozicion e dokumentacionit në fjalë, pashmangshmërisht është konsideruar fshehje e qëllimshme e subjektit të inspektuar për të penguar punën e grupit të inspektimit. Si dhe mos përmbushja e detyrimit sipas autorizimit të inspektimit për verifikimin e paisjeve nga grupi i inspektimit konsiderohet pengim në realizimin e objektit të inspektimit pasi heqja e këtyre paisjeve përpara fillimit të inspektimit, megjithë informacionin për zhvillimin e inspektimit, pengoi grupin e inspektimit të kryente verifikimin e CDR për trafikun e kryer në periudhën kohore objekt inspektimi.

13. Këshilli Drejtues i AKEP, pasi ka marrë në shqyrtim dhe vlerësim paraprak të gjithë veprimtarinë inspektuese pranë subjektit “Unifi Holding Inc, Dega Shqipëri”, të strukturës përkatëse pranë AKEP, ka arritur në konkluzionin se procedura inspektuese e ndjekur për këtë rast ka rezultuar të jetë kryer në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi dhe me Vendimin nr. 91 dt. 20.11.2018, ka miratuar propozimin e inspektorëve, për dhënien e masës administrative me gjobë, në vlerën 50.000.000 (pesëdhjetë milion) lekë, ndaj sipërmarrësit “Unifi Holding INC, dega Shqipëri”
14. Ankimi i paraqitur nga subjekti nuk përmban asnjë element të ri, prova të reja apo deklarime të tjera të pashqyrtuar më parë gjatë seancës dëgjimore të zhvilluar midis përfaqësuesve të subjektit dhe Këshillit Drejtues të AKEP si dhe analizës të kryer nëpërmjet Vendimi Nr.91, datë 20.11.2018, i cili sqaron në pikpamje teknike dhe ligjore të gjitha shkeljet e konstatuara e më tej të provuara nëpërmjet veprimtarisë inspektuese të strukturës përkatëse pranë AKEP.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Bazuar në pikën 1 të nenit 114, në pikën 1 të nenit 115 të ligjit nr.9918, datë 19.5.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Këshilli Drejtues i AKEP,

V E N D O S I:

1. Rrëzimin e ankimit andimstrativ të subjektit “Unifi Holding Inc, Dega Shqipëri”, me objekt “Anullimin e Vendimit për Dënim me Gjobë me Nr. Serie 000145, Nr.152, datë 06.12.2018 të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare”.
2. Lënien në fuqi të vendimit përfundimtar të Inspektimit nr.177, datë 06.12.2018.
3. Kundër këtij vendimi lejohet ankim gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda afatit 45 ditor të përcaktuar në Ligjin 49/2012.
4. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar

Anëtar

Anëtar

Ilir ZELA

Edlira DVORANI

Klarina ALLUSHI